

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: “SINANI ING” SH.P.K. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	09.08.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **09.08.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “SINANI ING” SH.P.K. me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RENOVIMI I OBJEKTIT TË VJETËR TË QKMF - së NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-21-4547-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-042-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e jashtë afatshme Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: “SINANI ING” SH.P.K. me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RENOVIMI I OBJEKTIT TË VJETËR TË QKMF - së NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-21-4547-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-042-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, pasi që e njëjta është parashtruar në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 5 dhe nenit 108/A të LPP-së, si dhe nenin 4 pika (b) të Rregullat për paraqitjen të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave.
- II. Autoriteti Kontraktues – Komuna e Rahovecit vendos të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit për aktivitetin e prokurimit: **RENOVIMI I OBJEKTIT TË VJETËR TË QKMF - së NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-21-4547-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-042-5-1-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik ankues: **SINANI ING” SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit:

1. Kërkesat për rishqyrtim

Data e dërgimit	Ofertuesi	Përshkrimi	Statusi i pyetjeve	Shkarko pyetjen	Shkarko përgjigjen
09.08.2021 11:50	SINANI - ING SH.P.K.	Kërkesë për rishqyrtim	Paraqitur	Shkarko 	
Vazhdo 					

Kundër njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RENOVIMI I OBJEKTIT TË VJETËR TË QKMF - së NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-21-4547-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-042-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit.

Ndërsa afati i fundit për Sqarimin e Dosjes së Tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka qenë data:

Sqarimi i Dosjes së Tenderit	16.1	06.08.2021
------------------------------	------	-------------------

B17 Dosja e Tenderit – Pune – Procedur e Hapur

14

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Sipas paragrafit 3 të nenit 108/A të Ligjit për Prokurim Publik dhe Nenit 4 “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së dhe vlera e tarifave të ankesave” i cili specifikon:

- Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë **(5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.**
- Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te një konkursi te projektimit brenda afatit prej **pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.**
- Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë **(5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.**

Autoriteti Kontraktues sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon:

Kalkulimi i afateve kohore

Operatori Ekonomik ankues Kërkesën për Rishqyrtim e ka paraqitur ne kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 5 të LPP-së në të cilën thuhet: ***Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.***

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si me lart AK Komuna e Rahovecit, konstaton se ankesa e OE-së: **“SINANI ING” SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim jashtë afatit ligjor, andaj e njëjta nuk hynë në shqyrtim.

Për këtë çështje ka dhe Interpretim nga KRPP-ja, tek Pyetjet e Shpeshta: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=268>

70. 06.02.2020. Afatet kohore në procedurën ankimore

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruar lidhur me kalkulimin e afateve ankimore, KRPP sqaron si në vijim:

Paragrafi 6 i nenit 108/A të LPP-së përcakton:

" Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë".

Në përputhje me paragrafin 7 të nenit 108/A të LPP-së ***"Kundër vendimit të autoritetit kontraktues, ankuesi mund të paraqesë një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së"***.

Neni 109 i LPP-së, përcakton:

"1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrtojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji".

Kukulimin e afateve kohore të përcaktuar me këtë ligj, e rregullon neni 5 i LPP-së.

Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni përcaktojnë:

"1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

2. Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj”.

Pra, sipas paragrafit 1 të nenit 5 të LPP-së, **afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe përfundojnë në një ditë pune.**

Nga data 01 Janar i vitit 2019 ka filluar **aplikimi i plotë i Platformës Elektronike të Prokurimit Publik** (Njoftimi i KRPP-së Nr. 91/2018, i dt. 26.12.2018) , prandaj edhe Kërkesa për rishqyrtim pranë AK-së si dhe Vendimi i AK-së duhet të komunikohen përmes platformës elektronike.

Si rrjedhojë,

1. Në rast se AK ka lëshuar një vendim në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji" **në datën e lëshimit (ngritjes në sistem) të vendimit të rishqyrtimit** dhe data e lëshimit (ngritjes në platformë) do të kalkulohet dita “zero” e afatit ankimor në OSHP.
2. Në rast se AK **nuk ka lëshuar një vendim dhe/ose nuk e ka njoftuar ankuesin për zgjatje të afatit të rishqyrtimit** (Paragrafi 6 i nenit 108/A të LPP-së) afati fillon të rrjedhë në ditën e tretë (3) (të fundit për kthimin e përgjigjes) pas pranimit të kërkesës nga OE e cila do të llogaritet dita “zero” e afatit për dorëzimin e ankesës në OSHP.
3. Në rast se AK **nuk ka lëshuar një vendim brenda tri (3) ditë, por e ka njoftuar ankuesin për zgjatje të afatit të rishqyrtimit** (Paragrafi 6 i nenit 108/A të LPP-së) afati fillon të rrjedhë në ditën e gjashtë (6) (të fundit për kthimin e përgjigjes), e cila do të llogaritet dita “zero” e afatit për dorëzimin e ankesës në OSHP.

Për të gjitha rastet “Vendimi i lëshuar” nënkupton Vendimin e ngritur në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik nga ana e AK-së. Operatorët Ekonomik dhe/ose palët e interesuara do të konsiderohen “ Të njoftuar” nga momenti kur AK e ngritë Vendimin në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik. **Çdo ankesë e parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 109 të LPP-së, do të refuzohet nga OSHP.**

Vendimi i AK-së në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji, ngritët në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik në përputhje me Njoftimin e KRPP-së Nr.15/2020, të dt. 28.01.2020.

KRPP do të monitorojë me kujdesin e veçantë autoritetet kontraktuese për mos nxjerrjen e një vendimi në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së dhe do të ndërmarrë masat në përputhje me Rregulloren Nr. 2/2017 për Procedurat e Dhënies dhe Revokimit të Certifikatës Profesionale për Prokurimin Publik.

Gjithashtu ka edhe VENDIMET nga OSHP lidhur me rast te ngjashëm për refuzim te një kërkesë te tille si ne vijim, i cili mund te merret parasysh:

Vendimi Nr. 559/21 i datës: 23.07.2021

Vendimi Nr. 550/21 i datës: 22.07.2021

Vendimi Nr. 546/21 i datës: 22.07.2021

Vendimi Nr. 545/21 i datës: 22.07.2021

Dhe plotë Vendimet tjera.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit

Data: 09.08.2021